



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1680/Prot.
11

Tiranë, më 22. 7. 2022

VENDIM

Nr. 19, datë 20. 07. 2022

*Mbi miratimin e formave të diplomave “Bachelor” në gjuhën angleze
në Fakultetin e Ekonomisë*

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2, gërma b; neni 35, pika 1, neni 38, pika 1, gërma “dh”; neni 80; Udhëzimin e MASR-së nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar, Kreu I, pika 2, dhe Statutin e Universitetit të Tiranës neni 31, gërmat f), j) dhe cc), neni 100; si dhe në propozimin e Fakultetit të Ekonomisë, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 20. 07.2022;

VENDOSI:

1. Të miratojë formën e diplomës për programet e studimit të ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Informatikë Ekonomike”, “Bachelor” në “Administrim Biznesi”, “Bachelor” në “Ekonomiks”, si dhe “Bachelor” në “Financë”.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i përcillet për procedura të mëtejshme Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

PROF. DR. ARTAN HOXHA